



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 4378 Prot.

Tiranë, më 19.04.2018

NJOFTIM

MBI MBYLLJEN E LLOGARIVE TË AUDITUESVE

Drejtuar: Autoriteteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) në ushtrim të kompetencave që i njeh Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si përgjegjëse për mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, ka konstatuar se nuk bëhet mbyllja e llogarive në sistem të llogarive të përdoruesve që hapen nga Administratorët e Sistemit për audituesit e jashtëm, pasi këta auditues janë larguar nga autoriteti kontraktor.

Në këto kushte, APP sjell në vëmendje të të gjithë Administratorëve të Sistemit të autoriteteve kontraktore se, në momentin që Audituesi apo Grupi i Auditimit largohet nga autoriteti kontraktor, duhet të procedohet me mbylljen e llogarisë së krijuar në sistem për Audituesin apo anëtarët e Grupit të Auditit.

Procesi i krijimit dhe mbylljes së llogarisë për Audituesin apo anëtarët e Grupit të Auditimit duhet të dokumentohet me anë mbajtjes së një procesverbali për këtë qëllim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

